



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM  
TIRANË

Nr. 12320 Regjistri Themeltar

Datë regj. 20.04.2026

Datë vendimi 24.04.2026

V E N D I M  
“PËR SIGURIMIN E PADISË”

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, e përbërë prej:

**GJYQTAR: FLAMUR KAPLLANI**

Sot më datë 24.04.2026, mori në shqyrtim në dhomë këshillimi, pa praninë e palëve, çështjen civile me Nr. 12320 Regjistri Themeltar, që i përket palëve:

**PADITËS:**

**Dionis Teqja**, i biri i Ahmet, i datëlindjes 25.06.1969, lindur në Peqin dhe banuese në Tiranë, në adresën : Bulevardi “Bajram Curri”, Nd.1824, H.1, Ap. 013, identifikuar me numër personal G90625209E. Përfaqësuar në gjykim nga zyra e avokatisë “Qirjako Attorneys at Law”, sipas prokurës së posaçme nr.90 Rep. Nr.18/1 Kol. Datë 16.01.2026, me adresë të zgjedhur për efekt njoftimesh: ATTI Tower, rruga “Ibrahim Rugova” 16”, kati 6, Tiranë.

**TË PADITUR:**

1. **“Hekla” shpk**, person juridik shqiptar, regjistruar në regjistrin tregtar me NUIS K21819004E, me seli në adresën: Rruga “Plazhi” 13, Hyrja nr.1, Ap. 66, Nr. pasurie 59/114/ ND +1-66, Durrës, përfaqësuar nga administratori z.Klaus Ciraku. (telegraf.al).

2. **“Zëri Media” shpk**, person juridik shqiptar, regjistruar në regjistrin tregtar me NUIS M32126006Q, me seli në adresën: Pallati “Kika 2”, Godina nr.8, Kati 8, Ap. 17, 1001 Tiranë, përfaqësuar nga administratorja znj.Fioda Berberi.

3. **“MCN 24” shpk**, person juridik shqiptar, regjistruar në regjistrin tregtar me NUIS L42404004, me seli në adresën: Lundër, Kodra e Derhemëve, nr.2, Lundër Tiranë, përfaqësuar nga administratori z.Endri Meksi.

4. “Media Solution” shpk, person juridik shqiptar, regjistruar në regjistrin tregtar me NUIS L61904020L, me seli në adresën: Rruga “Frederik Shiroka”, Kulla 3, Shkalla 3, Nr.4, Tiranë, përfaqësuar nga administratori z.Jetmir Olldashi.

5. “Dosja” shpk, person juridik shqiptar, regjistruar në regjistrin tregtar me NUIS L91601011O, me seli në adresën: Rruga “Ndre Mjeda”, Pallati AIC, Nr.31, Shkalla 5, Ap. 32, Kodi Postar 1023, Nr. pasurie 7/341 +2-33, zona kadastrale 8220, Tiranë, përfaqësuar nga administratori z.Enton Abilekaj.

6. “Vox News” shpk, person juridik shqiptar, regjistruar në regjistrin tregtar me NUIS M21402001A, me seli në adresën: Rruga “Hamdi Garunja” 1020, Pallati “Viki” shpk, Shkalla D, Ap.4D, Tiranë, përfaqësuar nga administratori z.Erjon Habilaj.

7. “Newsbomb” shpk, person juridik shqiptar, regjistruar në regjistrin tregtar me NUIS L42417011, me seli në adresën: Rruga “Emin Duraku”, Hyrja 1, Ap. 14, Tiranë, përfaqësuar nga administratorja znj.Anila Basha.

8. “EM Media” shpk, person juridik shqiptar, regjistruar në regjistrin tregtar me NUIS M51916003M, me seli në adresën: Rruga “Mihal Grameno”, Ap. 11, Tiranë, përfaqësuar nga administratori z.Emirjon Senja.

9. Ariglon Pali , person fizik, regjistruar në regjistrin tregtar me NUIS M32422019N, me seli në adresën: Njësia administrative Kashar, Rruga “28 nëntori”, Kompleksi Nova, Shkalla 2, Ap. 32, Kati 1, Hyrja 2, Tiranë, përfaqësuar nga z.Ariglon Pali.

10. Arsen Rusta , person fizik, regjistruar në regjistrin tregtar me NUIS K61819015A, me seli në adresën: Rruga “Komuna e Parisit”, Nd 1, Ap. 18, Tiranë, përfaqësuar nga z.Arsen Rusta.(Weblajm)

**OBJEKTI:**

1. Detyrimin e të paditurit Arsen Rusta, person fizik, (Weblajm.com) të shpërblejë paditësin Dionis Teqja për dëmin jopasuror në masën 500.000 euro, për shpifjet e publikuara në portalin online të palës së paditur.

2. Detyrimin e secilës prej palëve të tjera të paditura të shpërblejnë paditësin Dionis Teqja për dëmin jopasuror në masën 20.000 euro

secili, për shpifjet e publikuara në portalet online të palëve të paditura.

3. Detyrimin e palëve të paditura për të bërë përgënjeshttrimin në portalet online përkatëse.

4. Marrjen e masës së sigurimit të padisë, duke urdhëruar bllokimin e aksesit të publikut ndaj tyre, nga portali apo mediat online në të cilën ka publikuar artikujt shpifës dhe mashtrues, deri në dhënien e vendimit përfundimtar.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 3, 15/1, 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 10 i Konventës Europiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut; nenet 608, 609, 617 dhe 625/a të Kodit Civil; nenet 31, 32 e vijues, neni 202 e vijues i Kodit të Procedurës Civile.

✦ *Gjykata, pasi u njoh me kërkesëpadinë e paraqitur dhe aktet bashkëlidhur, në dhomë këshillimi, pa praninë e palëve;*

#### **VËREN SE:**

Pala paditëse i është drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë (Gjykata në vijim), me padinë, me objekt, palë dhe shkak ligjor si më lart.

Gjykata në vlerësim të nenit 205 e vijues të K.Pr.Civile, në dhomë këshillimi pa praninë e palëve, mori në shqyrtim kërkesën për marrjen e masës për sigurimin e padisë, sipas disponimit të palës paditëse.

#### **I. Faktet dhe pretendimet.**

Paditësi Dionis Teqja, është një sipërmarrës i mirënjohur i cili ushtron aktivitet tregtar brenda dhe jashtë vendit, nëpërmjet shoqërive tregtare që zotëron. Së fundmi, është vënë në dijeni se portalet online Gazeta Telegraf, Zëri, MCN TV, Skyweb.al, Boldnews, Dosja, Voxnews, Newsbomb, Maska dhe Weblajm, kanë publikuar shkrime në lidhje me aktivitetin tregtar që paditësi ushtron, për të cilat paditësi pretendon se janë shpifëse dhe të pavërteta.

Konkretisht, në portalet e mësipërme janë publikuar shkrimet e titulluara:

**1. Shpallet në kërkim pronari i Megatek, Dionis Teqja.** (titull identik ose pothuajse identik).

Publikuar nga portale / media online:

- Gazeta Telegraf: <https://telegraf.al/aktualitet/shpallet-ne-kerkim-pronari-i-megatek-dionis-teqja-ja-arsyeja/>
- Dosja.al: <https://dosja.al/aktualitet/gjykata-shpall-nc-kerkim-pronarin-e-megatek-dionis-teqja-1475900>

- Boldnees.al <https://boldnees.al/2025/12/30/gjykata-shpall-ne-kerkim-pronarine-megatek-dionis-tegia/>
- Voxnees al: [bupi.cee.toxners.al/english/aktimes/shpallet-ne-kerkim-pronari-i-megatek-dinus-regia-ia-angels-1107342](https://bupi.cee.toxners.al/english/aktimes/shpallet-ne-kerkim-pronari-i-megatek-dinus-regia-ia-angels-1107342)
- Alfapress al: <https://alfaprean.al/english/aktualitet/giskata-shpall-ne-kerkim-prunanns-megatek-dionis-tegia-1181710>
- Publikal; <https://pubhkal/shpallet-ne-kerkim-pronar-i-megatek/>
- Piranjat.al: <https://piranjat.al/aktualitet/gjykata-shpall-ne-kerkim-pronatin-e-megatek-dionis-tegia-162716>
- Maska.al: <https://maska.al/gjykata-e-tiranes-ne-kerkim-te-pronarit-te-megatek-dionis-regia/>
- Zerial; <https://zeri.ai/video-shpallet-ne-kerkim-pronari-i-megatek-dionis-teqja-1237169>
- Lajm i ri: <https://lajmiri.com/gjykata-leshon-urdher-kerkimi-per-pronarin-e-megatek-teqja/>
- Tempull: <https://tempull.com/index.php/2025/12/31/gjykata-shpall-ne-kerkim-pronarin-e-megatek-dionis-teqja/>
- Faktor.al: <https://faktor.al/2025/12/30/pronari-i-megatek-ne-kerkim-kush-e-ka-pare-te-njoftoje-policine/>

## **2. Drejtesia ne kerkim te pronarit te Megatek, Dionis Teqja. (titull identik ose pothuajse identik)**

Publikuar nga portale / media online:

- Skyeeb.al (Instagram): <https://eee.instagram.com/reel/DS5p3leD YX/>
- Skyeeb.al (Facebook): <https://eee.facebook.com/skyceb.al/videos/dreit%C3%ABsia-n%C3%AB-k%C3%ABrkim-t%C3%AB-pronarit-t%C3%AB-megatek-dionis-teqja/1358534005599503/>

## **3. Pronari i Megatek në kerkim / probleme me ortaket / proces gjyqësor. (i njejt i lajm, i riformular)**

Publikuar nga portale / media online:

- MCN TV (artikull): <https://ece.mcntv.al/lajme/kreu/24856a384d2e4867-942a59c638596998>
- MCN TV (artikull tjetër): <https://eee.mcntv.al/lajme/kreu/43923edc-9dbc-4ad7-97384cd4dcd1b5d0>

- Newsbomb.al:<https://necsbomb.al/aktualitet/nen-proces-giygesor-mebashkeaksionerin-gjykata-e-tiranes-shpall-ne-k-1381271>

#### 4. Video & rrjete sociale - riprodhim i te njëjtit titull/lajm.

Publikuar nga portale / media online:

- ZËRI : YouTube: <https://ccc.youtube.com/each?v=Q46p19iEzil>  
Facebook:<https://eee.facebook.com/zerimedia/videos/4108285129317091/>  
Instagram: <https://ece.instagram.com/reel/DS7z513CmH6/>  
Tik Tok: [https://ccc.tiktok.com/@zeri\\_al/video/759006305985527224](https://ccc.tiktok.com/@zeri_al/video/759006305985527224)
- MCN TV: YouTube: <https://eee.youtube.com/watch?v=R24k6VTozuM>  
Facebook: <https://eee.facebook.com/mcntv2021/videos/891301086659013/>

Paditësi pretendon se palët e paditura, përmes publikimeve të tyre në portale informative, rrjete sociale dhe platforma video, kanë përdorur në mënyrë të qëllimshme dhe të njëtrajtshme tituj sensacionale dhe të pavërtetë, duke aluduar dhe deklaruar se paditësi është “shpallur në kërkim” nga organet e drejtësisë, duke krijuar te publiku përshtypjen e rremë se ndaj tij ekziston një dënim penal apo gjendje kërkimi/ndjekje nga autoritetet ligjzbatuese. Konkretisht, këto artikuj shkruajnë:

#### ***“Shpallet në kërkim pronari i Megatek, Dionis Teqja. Ja arsyeja!***

*Pronari i Megatek, Dionis Teqja, prej më shumë se tre javësh kërkohet nga drejtësia shqiptare përkatësisht Gjykata e Tiranës. Shkak është mosgjetja e tij për të firmosur fletëthirrjen ndaj tij. Një proces civil mes aksionereve të një prej kompanive ku Teqja është aksioner, ka bërë që ai të njoftohet me një shpallje publike. Sipas argumentimit të gjykatës, siguruar nga Weblajm, mosparaqitja e tij në seancë dhe pamundësia e njoftimit me postë, e kanë detyruar gjykatën të bëjë shpallje publike. Teqja është paditur nga një prej ortakëve të tij në kompaninë postare “TNT Express Albania” sh.pk. Sipas të dhënave zyrtare, çështja civile mban numrin 1234 dhe daton më 10 dhjetor 2025. Paditës është Thanas Hyseni, ndërsa të paditur rezultojnë Ferdinand Haxhijaj, Dionis Teqja, shoqëria “RADMAIL” sh.p.k. dhe “T.N.T Express Albania” sh.p.k. Palë e tretë në proces është përfshirë edhe Qendra Kombëtare e Biznesit. Objekti i padisë lidhet me pavlefshmërinë e një vendimi të asamblesë dhe kërkesën për sigurim padie. Aksionari paditës, i cili zotëron një pjesë minoritare të kompanisë postare, pretendon se janë kryer veprime në kundërshtim me statutin e shoqërisë dhe ka kërkuar ndërhyrjen e gjykatës për pezullimin e efekteve të vendimeve të marra, deri në shqyrtimin përfundimtar të çështjes. Seanca e radhës gjyqësore është caktuar për datën 13 shkurt 2026, në orën 13.00, ku pritet që Dionis Teqja të paraqitet ose të përfaqësohet ligjërisht. Në të kundërt, procesi do të vijojë edhe në mungesë të tij, pasi njoftimi konsiderohet i vlefshëm sipas ligjit. Pas afishimit për një periudhë jo më pak se 20 dite, pala konsiderohet e njoftuar ligjërisht, pavarësisht nëse paraqitet apo jo.”*

Paditësi Dionis Teqja pretendon se këto publikime të të paditurve, kanë shkaktuar një dëm të madh dhe të riparueshëm në nderin dhe dinjitetin e tij për shkak të shtrembërimit të

së vërtetës, shpifjes dhe përmendjes së fakteve të pavërteta. Gjithashtu sipas tij, përhapja gjerësisht e këtyre deklaratimeve të pavërteta nga palët e paditura kanë zmadhuar dëmin dhe pasojat që i vijnë paditësit nga publikimi i këtyre deklaratave, për shkak se shoqëritë e zotëruara prej paditësit ushtrojnë aktivitetet tregtar edhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Në këto kushte paditësi i është drejtuar Gjykatës me padinë me objekt, palë dhe shkak ligjor si në pjesën hyrëse të këtij vendimi.

Duke qenë se sipas tij, paraqitet një rrezik i vazhdueshëm dhe progresiv për përhapjen, leximin, ripublikimin dhe shumëfishimin e këtyre artikujve, pasi ato janë të aksesueshëm nga cilido, brenda dhe jashtë Shqipërisë, ai ka kërkuar marrjen e masës së sigurimit të padisë dhe konkretisht detyrimin e palëve të paditura të heqin menjëherë nga portalet, platformat sociale dhe çdo mjedis tjetër dixhital ku janë publikuar, të gjithë artikujt me tituj mashtrues që lidhen me personin e paditësit Dionis Teqja, si dhe të bllokojnë aksesin publik ndaj tyre, deri në përfundimin e shqyrtimit gjyqësor të padisë.

## II. Vlerësimi i Gjykatës lidhur me masën e sigurimit të padisë.

Gjykata, referuar provave të paraqitura, pretendimeve të palës kërkuese, si dhe pasi bëri një interpretim të drejtë të dispozitave ligjore të zbatueshme në rastin konkret, vlerëson se kërkesa për marrjen e masës së sigurimit të padisë është e bazuar në ligj dhe në prova dhe si e tillë ajo duhet të pranohet.

Gjykata vlerëson të theksojë se kërkesa për sigurimin e padisë nuk përbën një gjykim themeli. Ajo është një mjet që inicion një gjykim që ka për qëllim garantimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor në aspektin e garancisë së një gjykimi efektiv, nëpërmjet të cilit të drejtat e fituara në gjykimin e themelit, do të mund të rivendosen në gjendjen e mëparshme në mënyrë të plotë duke siguruar në këtë mënyrë edhe dobishmërinë e vendimit të dhënë. Në vendimet *Reichert e Kockler* (Çështja C-261/90, Reichert) dhe *Van Uden* (Çështja C-104/03), Gjykata Europiane e Drejtësisë, i ka përkufizuar masat e përkohshme në kuptim të Konventës së Brukselit 1968 (Konventa e Brukselit “*Mbi Juridiksionin dhe Ekzekutimin e Vendimeve në Çështjet Civile dhe Tregtare*”) si: “*masa të destinuar të konservojnë/ ruajnë një situatë fakti ose të drejte me qëllimin për të mbrojtur ato të drejta, njohja e të cilave i takon gjyqtarit të themelit të çështjes të qartësojë*”.

Marrja e masave të përkohshme të sigurimit të padisë synon ta mbajë gjendjen ashtu siç është apo të ngrirë deri në zgjidhjen përfundimtare të konfliktit, e cila për vetë natyrën e çështjes duhet të realizohet nëpërmjet një procedure relativisht të thjeshtë, duke u kujdesur të respektohet një standard i pranueshëm i një procesi të rregullt ligjor (*Vendimi unifikues Nr. 10, datë 24.03.2004, i KBGjL*).

Kodi i Procedurës Civile i ka përcaktuar kushtet për sigurimin e padisë në nenin 202. Sipas kësaj dispozite: “*Sigurimi i padisë lejohet kur: a) padia mbështetet në prova me shkresë; b) paditësi jep garanci, në masën dhe në llojin e caktuar nga gjykata, për dëmin që mund t’i shkaktohet të paditurit nga sigurimi i padisë. Garancia mund të kërkohet edhe për rastin e parashikuar nga shkronja “a” e këtij neni.*”.

Praktika gjyqësore shqiptare, në interpretim të nenit 202 të K.Pr.Civile, ka vlerësuar se në gjykimin e kërkesave për sigurimin e padisë, në mënyrë që Gjykata të vendosë për marrjen e një mase sigurimi padie, të parashikuara këto të fundit në nenin 206 të K.Pr.Civile, duhet të hetojë ekzistencën e dy kushteve themelore: *i)* Ekzistenca e mundshme e një të drejtë për të cilën kërkohet mbrojtje gjatë procesit të gjyimit të padisë; *ii)* Ekzistenca e rrezikut që ekzekutimi i vendimit për të drejtën që kërkohet të mbrohet do të behet i pamundur ose i vështirë.

*Në lidhje me kushtin e parë*, është mëse e kuptueshme se pa ekzistencën e një të drejte nuk mund të mendohet mbrojtja e përkohshme e saj. Megjithatë, gjatë gjyimit të kërkesës për sigurim padie kërkuesi nuk ka detyrimin të provojë ekzistencën konkrete të të drejtës, kjo i takon themelit të padisë, por vetëm mundësinë e ekzistencës së saj dhe gjykatës i kërkohet vetëm verifikimi i një probabiliteti të arsyeshëm. Pra, në gjykimin e kërkesës për sigurimin e padisë nuk është e domosdoshme, që të jetë vërtetuar plotësisht ekzistenca e së drejtës që është edhe objekti i shqyrtimit gjyqësor dhe që ka lidhje me themelin e çështjes, por vetëm të ekzistojë mundësia e të drejtës që kërkohet të rivendoset.

Për të krijuar bindje në lidhje me mundësinë e ekzistencës të së drejtës që kërkohet të rivendoset, për gjykatën është e mjaftueshme që padia të jetë e mbështetur në prova shkresore, pasi këto të fundit i lejojnë gjykatës që të krijojë një njohje të shpejtë të së drejtës që pretendohet se është shkelur. Ky gjykim i ekzistencës së mundshme të së drejtës duhet të vlerësohen në mënyrë sipërfaqësore nga gjykata, sepse vlerësimi përfundimtar i provave, në bazë të të cilave gjykata do të krijojë bindjen për themelin e padisë, duhet t'i lihet gjyimit të themelit.

Në rastin objekt shqyrtimi, paditësi Dionis Teqja, ka ngritur pretendimin se palët e paditura e kanë cënuar në nderin dhe personalitetin e tij, duke i shkaktuar dëm moral, si kategori e posaçme e dëmit jopasuror.

Sipas provave shkresore të depozituara në Gjykatë, paditësi është zotërues dhe aksionar në disa kompani tregtare, të cilat ushtrojnë aktivitet tregtar brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Palët e paditura, të cilat janë media apo portale online, në muajin Dhjetor 2025, kanë publikuar një lajm lidhur me një proces gjyqësor civil ku paditësi ishte palë dhe për të cilin ishte bërë njoftimi nëpërmjet procedurës ligjore të shpalljes publike, nën titullin "*Shpallet në kërkim pronari i Megatek, Dionis Teqja. Ja arsyeja*". Ky lajm është i aksesueshëm nga publiku nëpërmjet klikimit të link-eve përkatëse dhe është ripublikuar nga të paditurit edhe herë të tjera pas publikimit fillestar.

Sa më sipër, për marrjen e masës së sigurimit të padisë, Gjykata nuk shqyrton në themel të drejtën për dëmshpërblim nga shkaktimi i dëmit jopasuror të palës paditëse, por verifikon legjitimitetin në pamje të parë (*prima facie*) të saj. Në këtë rast Gjykata vetëm vlerëson në mënyrë abstrakte nëse kërkimet dhe pretendimet e kërkueses gëzojnë mbrojtje ligjore, pa u ndalur në zgjidhjen konkrete të pretendimeve të saj.

Duke qenë se pretendimet e paditësit gëzojnë mbrojtje ligjore, Gjykata vlerëson se plotësohet kushti i parë i nenit 202 të Kodit të Procedurës Civile, për ekzistencën e mundshme të një të drejte për të cilën kërkohet mbrojtje gjatë procesit të gjyimit në themel të padisë.

*Në lidhje me kushtin e dytë që duhet të plotësohet për marrjen e një mase sigurimi padie, Kodi i Procedurës Civile në nenin 202 parashikon se: "... gjykata brenda 5 ditëve lejon marrjen e masave për sigurimin e padisë, kur ka arsye të dyshohet se ekzekutimi i vendimit për të drejtat e paditësit do të bëhet i pamundur ose i vështirë...." .*

Gjykata, në referim edhe të trajtimit doktrinar të institutit të sigurimit të padisë, vëren se në kushtin e dytë për marrjen e masave të sigurimit, dallohen dy kategori të rrezikut: *i)* Rreziku i mosekzekutimit të vendimit të themelit; *ii)* Rreziku nga vonesa në dhënien e vendimit të themelit.

Me rrezikun e mosekzekutimit të vendimit të themelit nënkuptohet rreziku që gjatë kohës së nevojshme për zhvillimin e procesit të themelit, mund të ndodhin fakte të tilla që e bëjnë pamundur ose të vështirë mundësinë e ekzekutimit konkret të vendimit të themelit.

Me rrezikun nga vonesa e vendimit të themelit nënkuptohet rreziku që mund t'i vijë rivendosjes së të drejtës thjesht nga zgjatja e procesit. Në këto raste, rreziku nuk vjen nga ndryshimi i rrethanave të faktit apo të të drejtës në të cilat do të bazohet vendimi i themelit, por pikërisht nga zgjatja, gjatë vonesave të procesit të zakonshëm.

Në prezencë të rrezikut të mosekzekutimit të vendimit të themelit, masa e sigurimit synon të parandalojë dëmin nga ndryshimi i fakteve që mund të pengojnë realizimin e të drejtës objekt konflikti. Ndërkohë, në prezencë të rrezikut nga vonesa, masa e sigurimit duhet të pengojë, dëmin që vazhdimi i një situatë antiligjore mund t'i shkaktojë të drejtës.

Në rastin objekt shqyrtimi, Gjykata çmon se padia e ngritur nga paditësi, ka si objekt dëmshpërblimin e tij nga të paditurit, për shkaktimin e dëmit jopasuror (moral), nga publikimet e pavërteta dhe mashtruese lidhur me personin e tij, nga mediat dhe portalet online, të thërritura në cilësinë e palëve të paditura në këtë proces.

Sa më sipër, Gjykata krijon bindjen mbi ekzistencën e rrezikut të dëmeve ndaj interesave të ligjshëm të paditësit, që mund të vijnë, nga aksesimi i vazhdueshëm nga publiku i gjerë ndaj artikujve të publikuar nga mediat/portalet online lidhur me personin e paditësit Dionis Teqja. Këto artikuj janë ende të pranishëm online dhe aksesohen, indeksohen dhe ri-indeksohen nga motorë kërkimi kombëtarë e ndërkombëtarë; skanohen nga sisteme automatike të pajtueshmërisë ndërkombëtare KYC/AML (Know Your Customer/Anti-Money Laundering), duke e ruajtur paditësin në listën e subjekteve me profil rreziku të lartë; si dhe mund të lexohen, ripublikohen nga subjekte të reja. Në këtë rast, dëmi do t'i vinte paditësit nga vonesa e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të themelit, pasi vazhdimi i një situatë antiligjore, do ta bënte të pamundur realizimin e së drejtës së tij për dëmshpërblimin për shkaktimin e dëmit jopasuror nga palët e paditura.

Sa më sipër, Gjykata vlerëson se ka arsye të dyshohet se ekzekutimi i vendimit përfundimtar për të drejtat e paditësit do të bëhet i pamundur ose i vështirë, nëse nuk merret masa e sigurimit të padisë, duke u plotësuar kështu edhe kushti i dytë i nenit 202 të Kodit të Procedurës Civile.

Paditësi e mbështet kërkesën për sigurimin e padisë në prova me shkresë të depozituara së bashku me kërkesën, që mundësojnë që Gjykata të vlerësojë ekzistencën

*prima facie* të interesit të ligjshëm të saj në gjykimin e çështjes dhe të rrezikut që mund t'i vijë nga mosekzekutimi i vendimit përfundimtar të Gjykatës.

Së fundi, përsa i përket masës konkrete e cila vlerësohet si më përshtatshme dhe e dobishme për të mbrojtur të drejtat e pretenduara të kërkuases, Gjykata vëren se neni 206 i K.Pr.Civile, parashikon se: “*Sigurimi i padisë bëhet: a) me sekuestrimin e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme si dhe të kredive të debitorit; b) me anë të masave të tjera të përshtatshme të marra nga gjykata. (...)*”.

Në interpretim të kësaj dispozite, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në vendimin unifikues Nr.10, datë 24.03.2004, janë shprehur se: “*Marrja e masave të përkohshme të sigurimit të padisë synon ta mbajë gjendjen ashtu siç është, apo të ngrirë deri në zgjidhjen përfundimtare të konfliktit, e cila për vetë natyrën e çështjes duhet të realizohet nëpërmjet një procedure relativisht të thjeshtë, duke u kujdesur të respektohet një standard i pranueshëm i një procesi të rregullt ligjor.*”.

Nga sa më sipër Gjykata vlerëson si masë të përshtatshme dhe proporcionale në kuptim të ligjit, urdhërimin e palëve të paditura të heqin menjëherë nga portalet, platformat sociale dhe çdo mjedis tjetër dixhital ku janë publikuar, të gjithë artikujt me tituj mashtrues që lidhen me personin e paditësit Dionis Teqja, si dhe të bllokojnë aksesin publik ndaj tyre, deri në përfundimin e shqyrtimit gjyqësor të çështjes.

Përfundimisht, për sa sipër, Gjykata vlerëson se, kërkesa e palës paditëse për marrjen e masës së sigurimit të padisë është e bazuar në ligj dhe prova dhe si e tillë duhet pranuar.

#### **PËR KËTO ARSYE,**

Gjykata bazuar në nenet 126, 202, 203, 204, 205, 206/b të Kodit të Procedurës Civile,

#### **VENDOSI:**

1. Pranimin e kërkesës së paditësit Dionis Teqja për sigurimin e padisë.
2. Marrjen e masës së sigurimit të padisë, **duke urdhëruar palët e paditura të heqin menjëherë nga portalet, platformat sociale dhe çdo mjedis tjetër dixhital ku janë publikuar, të gjithë artikujt me tituj mashtrues që lidhen me personin e paditësit Dionis Teqja, si dhe të bllokojnë aksesin publik ndaj tyre, deri në përfundimin e shqyrtimit gjyqësor të çështjes.**
3. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi i veçantë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë brenda 5 (pesë) ditëve, duke nisur ky afat nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

**U shpall në Tiranë, sot më datë 24.04.2026.**

**GJYQTAR**

**Flamur KAPLLANI**

